

## CENZUSI NDËRKOMBËTAR I SHPENDËVE TË UJIT (IWC) 2019 NË KOSOVË

Autorë: Qenan Maxhuni<sup>1</sup>, Taulant Bino<sup>2</sup>, Erald Xeka<sup>2</sup>, Besjana Sevo<sup>2</sup>, Erald Bejko<sup>2</sup> & Jeton Muhaxhiri<sup>3</sup>

<sup>1</sup>Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

<sup>2</sup>AOS-Albanian Ornithological Society

<sup>3</sup>Ekspert i pavarur

Në kuadër të aktiviteteve për monitorimin dhe inventarizimin e biodiversitetit, gjatë fundjavës së kaluar (19-20.01.2019) Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës me ndihmën vullnetare të ekipës së ekspertëve nga Shoqata Ornitologjike e Shqipërisë (AOS-Albanian Ornithological Society) ka kryer për herë të parë në Kosovë Censusin Ndërkombëtar të Shpendëve të Ujit.

Ky numërim që u realizua pothuajse në të gjitha vendet ku ka prezencë të baseneve ujore dhe u mbështet gjithashtu edhe nga disa dashamirës të natyrës.

Aktiviteti është realizuar në kuadër të IWC 2019 (International Waterbird Census) që organizohet në nivel botëror, që prej 53 vitesh, nga Wetlands International.

Duke marrë parasysh dimrin e acartë të këtyre ditëve pjesa më e madhe e sipërfaqeve ujore të vizituara ishin plotësisht të ngrira. Liqeni i Batllavës, i Livoqit, i Përlepnicës, Ligatina e Hencit dhe ajo e Parteshit ishin tërësisht të mbuluara nga akulli. Vërmica ishte thuhet pa ujë për shkak të rënies së nivelit të ujit në Liqenin e Fierzës ndërkaq sipërfaqet ujore të mbetura në të ishin tërësisht të ngrira.

Të vetmet sipërfaqe, pjesërisht të ngrira, ku kishte shpendë uji ishin Liqeni i Badovcit, Liqeni i Radoniqit si dhe disa liqene të vogla përreth termocentralit të Obiliqit (në afërsi të Deponisë së Mbeturave në Mirash). Këtu strehohej dhe numri më i madh i shpendëve të ujit.

Nga rezultatet paraprake mund të konstatohet se u vrojtuan 12 lloje të shpendëve të ujit me një numër total prej 9.178 individësh gjithsej. Shumica e shpendëve të ujit të numëruar me këtë rast ishin rosa ku *Anas platyrhynchos* me 6632 individë dhe *Anas crecca* me 2398 individë përbënin së bashku 98,38% të numrit të të përgjithshëm të shpendëve. Lista complete e shpendëve ujqorë është si më poshtë:

Nr.	Llojet shpend uji	Radoniq	Henc	Obiliq	Badovc	Batllavë	Përlepnicë	Livoc	Vermicë	Partesh	Total
1	<i>Anas crecca</i>	22		2376							2398
2	<i>Anas platyrhynchos</i>	2526		3969	137						6632
3	<i>Ardea alba</i>	2									2
4	<i>Ardea cinerea</i>		1	2							3
5	<i>Chroicocephalus ridibundus</i>			20							20
6	<i>Fulica atra</i>	44		50							94
7	<i>Gallinula chloropus</i>			1							1
8	<i>Gavia arctica</i>	1									1
9	<i>Phalacrocorax carbo</i>	4									4
10	<i>Podiceps nigricollis</i>	6									6
11	<i>Podiceps cristatus</i>	12		1							13
12	<i>Tachybaptus ruficollis</i>	2		2							4
	<b>TOTAL</b>	<b>2619</b>	<b>1</b>	<b>6421</b>	<b>137</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>9178</b>

Në Liqenin e Radoniqit, përveç shpendëve të tjerë u vërejt dhe prezenca e *Gavia arctica* që u cilësua një surprizë jo vetëm për këtë zonë por në përgjithësi për vendin meqenëse nuk kishte të dhëna të mëhershme për praninë e saj tek ne.

Dy zonat kryesore për shpërndarjen e shpendëve të ujit për janarin 2019 rezultojnë të jenë Liqenet e Obiliqit (pranë deponisë së hirit të termocentralit), Liqeni i Radoniqit dhe ai i Badovcit, si të vetmet sipërfaqe ujore që nuk ishin plotësisht të mbuluara nga akulli. Kjo situatë e vërejtur mund të ndryshojë me shkrirjen e akullit.

Përveç shpendëve të ujit që ishin në fokus të këtij aktiviteti, në zonat ligatinore u shënua dhe prania e shpendëve të tjerë jo-ujorë që i përdorin këto ekosisteme për tu ushqyer gjatë dimërimit.

Nga 31 lloje shpend jo-ujorë të vrojtuar, 6 lloje i takonin rrëmbenjësve të ditës (shënuar me bold). Ndër më të zakonshmit është *Buteo buteo* që duket se gjendet më me shumicë se llojet e tjera.

Nr.	Llojet shpend jo-ujorë	Radoniq	Henc	Obiliq	Badovc	Batllavë	Përlepnicë	Livoc	Vermicë	Partesh	Total
1	<i>Accipiter gentilis</i>		1								1
2	<i>Accipiter nisus</i>									1	1
3	<i>Athene noctua</i>		1			1					2
4	<b><i>Buteo buteo</i></b>	7	11	2		3			1	1	25
5	<i>Caduelis cannabina</i>					3					3

6	<i>Carduelis carduelis</i>			7						15	22
7	<i>Circus aeruginosus</i>	1									1
8	<i>Circus cyaneus</i>	1									1
9	<i>Coloeus monedula</i>			18						33	51
10	<i>Corvus corax</i>	2	2	4	1	2				4	15
11	<i>Corvus cornix</i>	4		2	3	3			3	7	22
12	<i>Corvus frugilegus</i>	3	2	7	3	3				10	28
13	<i>Cyanistes caeruleus</i>		1			3					4
14	<i>Dendrocopos major</i>					1					1
15	<i>Dryocopus martius</i>					1					1
16	<i>Emberiza citrinella</i>		1								1
17	<i>Falco tinnunculus</i>	1	1	4						1	7
18	<i>Fringilla coelebs</i>		4		3	7	5	3			22
19	<i>Fringilla montifringilla</i>			20							20
20	<i>Garrulus glandarius</i>		2		1	7	1				11
21	<i>Lanius excubitor</i>	1									1
22	<i>Nucifraga caryocatactes</i>					2					2
23	<i>Parus major</i>		3	1		3		2	1		10
24	<i>Passer domesticus</i>					3		4		15	22
25	<i>Passer montanus</i>		11	3	5	22		3		9	53
26	<i>Perdix perdix</i>									3	3
27	<i>Phylloscopus collybita</i>					2					2
28	<i>Pica pica</i>		8	7							15
29	<i>Streptopelia decaocto</i>		15			2					17
30	<i>Sturnus vulgaris</i>					55					55
31	<i>Turdus merula</i>		2			3					5
	<b>Total</b>	<b>20</b>	<b>65</b>	<b>75</b>	<b>16</b>	<b>126</b>	<b>6</b>	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>99</b>	<b>424</b>

Në këtë listë të shpendëve jo-ujorë është për tu shënuar prania e *Lanius excubitor*, një lloj dimëruës për faunën e Kosovës. Ky mund të jetë vrojtimi i dytë i këtij lloji në Kosovë.

Në përfundim, ky Census Ndërkombëtar i Shpendëve të Ujit i zhvilluar në Kosovë, hap rrugën për përsëritjen dhe përmirësimin e këtij aktiviteti edhe në vitet e ardhshme.

Përveç ligatave të mësipërme organizatorët do të përpiqen të përfshijnë në numërim edhe sipërfaqe të tjera ujqor sikurse sipërfaqet ujqore lumore si të vetmet pjesë ujqore ende jo të ngrira gjatë dimrit të acartë.

Censusi 2019 i shërben njohjes më të mirë të vlerave të eksositemeve ligatinore të Kosovës, i shërben njohjes më të mirë të rëndësisë së këtyre ekosistemeve për shpendët e ujit si dhe mundëson mbrojtjen më të mirë dhe menaxhimin e duhur të tyre në të ardhmen.

Prishtinë, 22.01.2019